Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Prishtinë, 21 shtator 2023
Kodi i ZRRE-së: V_1767_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenin 14 par. 4 nënpar. 4.3, Neni 15 paragrafi 7 nënparagrafi 7.4, Nenit 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 6, paragrafi 6.4, nënparagrafi (h) dhe neni 7.3 nën-paragrafi (f) Marrëveshjen kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës,;
- Dispozitat e Nenit 73 paragrafi 1 të Rregullores së Komisionit Europian (EU) 2015/1222 CACM (Alokimi i kapaciteteve dhe Menagjimi i Kongjestionit),
- Vendimin V_1332_2020 të datës 10 dhjetor 2020,
- Vendimin V_1637_2022 të datës 27 dhjetor 2022,
- Vendimin V_1638_2022 të datës 27 dhjetor 2022
- Vendimin V_1748_2023 të datës 17 korrik 2023,
- Kërkesën e KOSTT SH.A. nr. 1637 të datës 21.08.2023 për aprovimin e Metodologjisë së Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 21 shtator 2023 nxori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET -** Metodologjia e Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.

II. Metodologjia e Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni Ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, sipas dispozitivit nën pikën I të këtij Vendimi, do të fillon të zbatohet pas miratimit nga Enti Rregullator i Shqipërisë (ERE) dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) me fillimin e operimit të tregut të përbashkët të energjisë elektrike mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 21.08.2023 ka pranuar nga KOSTT SH.A. kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të Metodologjisë së Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni Ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.
- Metodologjia është hartuar nga OST/KOSTT dhe NEMO e Shqipërisë dhe Kosovës, dhe objektivi kryesor i dokumentit është të rregullojë mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni për zonat ofertuese të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës bazuar në qasjen e NTC-së, së koordinuar në harkun kohor të ditë në avancë. ALPEX llogarit të ardhurat nga kongjestioni, për secilën Njësi Kohore të Tregut (MTU) në Euro, dhe OST dhe KOSTT, do të marrin pjesën e tyre të të ardhurave neto kufitare bazuar në një koeficient të ndarjes 50% me 50%.
- ZRRE, në përputhje me kërkesat ligjore, ka vendosur dokumentin në konsultim publik, ku palët e interesuara kanë pasur mundësi të paraqesin komentet dhe qëndrimet e tyre lidhur me çështjet e trajtuara në këtë dokument.
- Pas përfundimit të konsultimit publik, dhe pas përfshirjes së komenteve të palëve, dokumenti është përgatitur për shqyrtim dhe miratim në ZRRE.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit ka konstatuar se dokumenti Metodologjia e Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni Ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës është në përputhje me kërkesat ligjore, dhe ka vlerësuar se i njëjti është i domosdoshëm me qëllim të funksionimit të sigurt të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: - Metodologjia e Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni Ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Arta Isufi, anëtare

Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- ALPEX SH.A. – Dega në Kosovë
- KOSTT, dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.